



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, datë 11.08.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve online, mbështetur në rrjet (IP) OTT “Vodafone TV”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
(Vendimi nr. 82, datë 11.08.2026)
2. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Acenet” sh.p.k, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Acenet”, për të mbuluar me sinjal “*Bashkinë Lushnje dhe Njësinë Administrative Poshnjë*”.
(Vendimi nr. 83, datë 11.08.2026)
3. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 23, datë 10.06.2026 të vendosur ndaj shoqërisë “Johaniteri” sh.p.k.
(Vendimi nr. 84, datë 11.08.2026)
4. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 26, datë 19.06.2026 të vendosur ndaj shoqërisë “Johaniteri” sh.p.k.
(Vendimi nr. 85, datë 11.08.2026)
5. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 27, datë 24.06.2026 të vendosur ndaj shoqërisë “Media Vizion” sh.p.k.
(Vendimi nr. 86, datë 11.08.2026)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 11 Gusht 2026